



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS KAMENICË

Numri i lëndës: 2024:132814

Datë: 12.07.2024

Numri i dokumentit: 05934424

C.nr.373/2024

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA NË KAMENICË, Departamenti i Përgjithshëm/ Divizioni Civil, gjyqtarja Valbonë Dërvodeli, me bashkëpunëtorin profesional Irfan Thaqi, në çështjen juridike kontestimore të paditësve: A.D.nga ..... dhe M.D. nga ....., të cilët sipas autorizimit i përfaqëson Selmon Sadiku, avokat nga Kamenica, kundër të paditurës Komuna e Kamenicës-Drejtoria e Arsimit, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Alban Hashani, jurist nga Kamenica, me objekt kontesti kompensimin e shujtës ditore dhe shpenzimet e udhëtimit, me vlerë të kontestit 1,518.00 euro, jashtë seancës, më datë 12.07.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET PJESËRISHT si e bazuar në ligj kërkesëpadia e paditësve: A.D nga ....dhe M. D. nga ....., dhe DETYROHET e paditura Komuna e Kamenicës, që paditësve t'u paguaj edhe atë, për:

1. A.D., në emër të kompenzimit të shpenzimeve për ushqim ditor, për periudhën nga data 03.03.2023 – 29.03.2024, për 183 ditë pune, shumën prej 366.00 euro, ndërsa në emër të shpenzimeve të udhëtimit, në lartësi të biletës se trafikut urbanë, shumën prej 88.00 euro, e këto në shumë të përgjithshme të hollave prej **418.00 euro**, me kamatë ligjore prej 8% nga dita e ushtrimit të padisë, të gjitha këto në afat prej 7 ditë, pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbartimit ligjor.

2. M. B., në emër të kompenzimit të shpenzimeve për ushqim ditor, për periudhën nga data 22.11.2022 – 05.04.2024, për 275 ditë pune, shumën prej 550.00 euro, ndërsa në emër të shpenzimeve të udhëtimit, në lartësi të biletës se trafikut urbanë, shumën prej 275.00 euro, e këto në shumë të përgjithshme të hollave prej **825.00 euro**, me kamatë ligjore prej 8% nga dita e ushtrimit të padisë, të gjitha këto në afat prej 7 ditë, pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbartimit ligjor.

2.1. Pjesa tjetër e kërkesëpadisë për kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit, në shumë prej 275.00 euro, REFUZOHET SI E PA BAZUAR.

II. DETYROHET e paditura, që paditësve t'ia paguajë shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë të përgjithshme prej 186.00 euro, në afat prej 7 ditë, pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarrimit ligjor.

### A r s y e t i m i

Paditësit, përmes të autorizuarit të tyre, më datë 18.04.2024, në këtë gjykatë, kanë paraqitur padi kundër të paditurës Komuna e Kamenicës-Drejtoria e Arsimit, me objekt kontesti kompensimin e shujtës ditore dhe shpenzimet e udhëtimit, me vlerë të kontestit prej 1,518.00 euro. Në padi kanë theksuar se paditësit janë në marrëdhënie pune të e paditura, në pozitën e mësimdhënësve. Baza ligjore për kompensimin e shujtës ditore në lartësi 2 euro, për paditësin e parë për 183 ditë pune, shumën prej 366.00 euro dhe kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit, shumën prej 88.00 euro, ndërsa për paditësin e dytë për 275 ditë pune, shumën prej 550.00 euro, dhe kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit, shumën prej 550.00 euro, ka theksuar se gjendet në Kontratën Kolektive në Nivel të Ndërmarrjes, të dt.31.01.2020, në nenin 4 dhe 16 parag.1 dhe 5, e lidhur ndërmjet Komunës së Kamenicës dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës të Kosovës. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar edhe atë 156 euro për përpilimin e padisë, si dhe shumën prej 30 euro për taksën gjyqësore.

Gjykata konform nenit 394, 395 dhe 396 të dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore (në vijim: LPK-së) të paditurës i ka dërguar aktvendimin për përgjigje në padi, së bashku me padinë dhe provat e bashkëngjitura padisë për tu deklaruar me shkrim në padinë e paditësit.

E paditura, me anë të përgjigjes në padi, ka theksuar se është i pakontestueshëm fakti se paditësit janë në marrëdhënie pune të e paditura, po ashtu ka theksuar se paditësit nuk kanë ofruar asnjë provë materiale se Komuna e Kamenicës, në draft buxhetin për vitin 2023, është parapare ndarje e ndonjë pjese të buxhetit për realizimin e të drejtave dhe detyrimeve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive, dhe se duke u bazuar në ndarjet buxhetore për vitin 2023 për sektorin e arsimit në Komunën e Kamenicës, në kategorinë e shpenzimeve në pjesën e IV shihet se nuk ka ndarje buxhetore. Në bazë të nenit 16 parag.1, e paditura për shkak të ungesës së buxheit dhe pa mundësi të financiare nuk ka bërë ndonjë ndarje specifike për kompensimin e shujtës ditore press ë paku 2 (dy) euro, për një ditë pune, me tutje ka shtuar se e kundërston kërkesëpadinë e paditësit edhe nga fakti se palët nënshkruese të kësaj kontrate kanë shprehur në mënyrë deklarative mundësinë e vullnetit të përmbushjes së nenit 16, nga të lartëcekurat i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditësve ta refuzoj si të pa bazuar. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Gjykata, pas pranimit të përgjigjes në padi, ka gjetur se janë plotësuar kushtet ligjore të përcaktuara në nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së) për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës, sepse në mes të palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, pasi që nga përgjigja në padi rezulton qartasi se padia e paditësve është tërësisht e bazuar.

Gjykata, para se të vendos në mënyrë meritorë në këtë çështje kontestimore i ka vlerësuar kushtet ligjore nga neni 398 i LPK-së, me të cilin përcaktohet se “*kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta japë aktgjykimin me të cilin e pranon si të themeltë kërkesëpadinë*”, dhe ka konstatuar se ekzistojnë kushtet ligjore për marrjen e këtij Aktgjykimi, pasi që faktet vendimtare nuk janë kontestuar nga ana e të paditurës, respektivisht nuk është kontestuar gjendja faktike, se paditësit janë në marrëdhënie pune tek e paditura, paditësi i parë në pozitën e leogopedes, nërsa paditësi i dytë ne pozitën e mësimdhënësit.

Andaj, gjykata sa i përket të drejtës subjektive të paditësve dhe lartësisë së tyre, ka zbatuar dispozitat e Kontratës Kolektive në nivel të Ndërmarrjes, të datës 31.01.2020, konkretisht nenin 16 paragrafi 1 të kësaj Kontrate, ku citohet se 1.“*Sipas mundësisë financiare të Punëdhënësit, të punësuarit do të kompensohen ne emër të shujtës ditore në shumë prej së pagu 2 (dy) euro për një ditë pune; 2. Kompensimi ne emër të shujtës ditore do të bëhet nga Punëdhënësi në bazë mujore, në periudhë korelative me kompensimin e pagës mujore*”. Andaj, gjykata e obligoj të paditurën që paditësve t’ia kompensoj për paditësin e parë për 183 ditë pune, shumën prej 366.00 euro për ditët e pranisë në punë nga dt. 03.03.2023 – 29.03.2024, ndërsa për paditësin e dytë për 275 ditë pune, shumën prej 550.00 euro, për ditët e pranisë në punë nga dt. 22.11.2022 – 05.04.2024.

Gjykata, ka gjetur se mes palëve nuk janë kontestuese faktet se paditësit janë te punësuar pranë të paditurës, as fakti se paditësi i parë ka 183 ditë pune, ndërsa paditësi i dytë ka 275 ditë pune (fakt ky i vërtetuar nga vërtetimi nr.16, i dt.29.03.2024, i lëshuar nga SHFMU “Avni Rrustemi”, në fshatin Karaqevë e Epërme, vërtetimi nr.62 i dt.15.03.2024, i lëshuar nga SHFMU “Abdullah Krashnica-Presheva” në fshatin Koretin, në emër të A.M. dhe vërtetimi nr.233, i dt.05.04.2024, i lëshuar nga SHFMU “Rexhep Mala”, në fshatin Topanicë, në emër të M. B.), por kontestues është fakti se a ka bazë ligjore për kompensim e shujtës ditore.

Po ashtu e paditura ka qenë e detyruar që paditësve t’ia kompensojë edhe shpenzimet e udhëtimit në lartësi të çmimit të plotë të biletës, nga fakti se dispozita e nenit 35 parag.5 i Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, citohet “*Të punësuarve në institucionet e arsimit që kanë vendbanimin në distancë nga vendi I punës, do t’u takojë kompensimi i shpenzimeve të transportit për ardhje-vajtje në vendinm e punës, në lartësi të çmimit të plotë të biletës në transportin publik*”, dispozit kjo e cila është e zbatueshme ngase KKN është ende në fuqi, dhe se asnjëra palë kontraktuese nuk e kanë shkëputur të njëjtën, e nga ky fakt për Komunën e Kamenicës, rrjedh detyrimi edhe për kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit për të punësuarit në sistemin arsimor. Gjykata, sa i përketë shpenzimeve të udhëtimit është bazuar në Certifikatat e vendbanimit, ne emër të paditësve, me të cilat vertetohet se vendbanimi i paditësit të parë është fshati Koretin, ku qmimi i biletës nga ky fshat për në fshatin Karaqevë e Epërme, për dy drejtime është 2.00 euro, ndërsa vendbanimi i paditësit të dytë është Kamenica, ndërsa qmimi i biletës nga Kamenica, për në fshatin Topanicë, për dy drejtime është 1.00 euro, fakte këto të vërtetuara nga vërtetimi i lëshuar nga SHTU “Anamorava”, në Gjilan, si në shkresat e lëndës.

Në bazë të nenit 329.1 të LPK-së, provat në shkresat e lëndës, gjykata i gjeti vendimtare për vendosje në këtë çështje meritore, pasi të njëjtat janë lëshuar nga organi shtetëror – këtu vet e paditura, brenda kufijve të kompetencës së vet, duke provuar saktësinë e thënieve në këto dokumente.

Me Ligjin e Punës nr.03-L/212 parashihet se sa i përket çështjeve të punëdhënësit me punëmarrësin ata të drejtat dhe detyrimet e tyre mund t'i rregullojnë edhe me Kontratë Kolektive dhe Kontrata Kolektive nuk mund të përmbajë të drejta më pak të favorshme për të punësuarin dhe punëdhënësin se sa të drejtat e përcaktuara me Ligj të punës, pra të drejtat e punëmarrësit me Kontratën Kolektive mund të avancohen më lartë se të drejtat e parapara me Ligjin e Punës.

Pretendimet e përfaqësuesit të palës së paditur në përgjigje në padi, se paditësit nuk kanë ofruar asnjë provë materiale se Komuna e Kamenicës, në draft buxhetin për vitin 2023, të ketë paraparë ndarjen e ndonjë pjese të buxhetit për realizimin e të drejtave dhe detyrimeve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive në kuadër të Ndërmarrjes, dhe se duke u bazuar në ndarjet buxhetore për vitin 2023 për sektorin e arsimit në Komunën e Kamenicës, në kategorinë e shpenzimeve në pjesën e IV shihet se nuk ka ndarje buxhetore, për gjykatën këto pretendime ishin të pa bazuara, për faktin se me nenin 1, të Kontratës Kolektive në kuadër të Ndërmarrjes, citohet se *“KKN lidhet nga palët në këtë kontratë për avancimin e rregullimit të marrëdhënieve juridike nga marrëdhënia e punës dhe respektimit të të drejtave dhe detyrimeve të palëve nënshkruese”*, prandaj, Komuna e Kamenicës, është e obliguar ta zbatojnë KKN dhe me kohë të planifikojnë mjete buxhetore për këto raste, po ashtu duke u bazuar në nenin 2, të kësaj kontrate, ku citohet se *“Kjo kontratë zbatohet në marrëdhënie të punës vetëm për të punësuarit në sektorin e arsimit të cilët janë anëtarë të SBASHK-ut, brenda territorit të Komunës së Kamenicës, si njësi unike e punës”*, paditësi, në rastin konkret, hynë në kuadër të përfituesve të të drejtave që rrjedhin nga kjo Kontratë, meqë të njëjtat janë të punësuar të e paditura. Andaj, përgjegjësia për kompensimin shujtës ditore dhe shpenzimet e udhëtimit është te e paditura, respektivisht të DKA-së, në Kamenicë.

Gjykata, pjesën tjetër të kërkesëpadisë për kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit në lartësi prej 275.00 euro, për paditësin e dytë, e refuzoi si të pa bazuar nga fakti se çmimi i biletës nga fshati Topanicë për në Kamenicë, është 0.50 euro, një drejtim, respektivisht 1.00 euro, në dy drejtime. Deri të ky konstatim gjykata erdhi duke u bazuar në vërtetimi i lëshuar nga SHTU “Anamorava”, në Gjilan, prandaj gjykata ka vendosur si në pikën 2.1 të dispozitivit.

Gjykata për kamatën ligjore prej 8 % ka vendosur duke u bazuar në dispozitën e nenit 382 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD-së).

Gjykata duke patur parasysh suksesin në procedurë të paditësit dhe duke u bazuar në nenin 449, 452 dhe 463, paragraf 1 të LPK-së, ashtu që e ka detyruar të paditurën që paditësit t'ia paguaj shpenzimet e procedurës, edhe atë: për përpilimin e padisë, shumën prej 156.00 euro dhe për taksë gjyqësore, shumën prej 30.00 euro, e në shumën e përgjithshme prej 186.00 euro.

Gjykata, nga të lartëcekurat e bazuar në nenin 143, paragrafi 1 lidhur me nenin 398 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJILAN – DEGA NË KAMENICË  
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil  
C.nr.373/2024, më datë 12.07.2024

Gjyqtarja,  
Valbonë Dërvodeli , d.v

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë, në afat prej 7 ditë, pas ditës së pranimi të të njëjtit. Ankesa dorëzohet në dy ekzemplar përmes kësaj gjykate.